




AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

STRATEGJIA

për zbatimin e së drejtës për
**mbrojtjen e të dhënave
personale** në Republikën
e Maqedonisë së Veriut
për periudhën
2025 – 2030



Financuar nga
Bashkimi Evropian

STRATEGJIA

për zbatimin e së drejtës për
mbrojtjen e të dhënave personale
në Republikën e Maqedonisë së Veriut
për periudhën 2025 – 2030



Strategjia u hartua me mbështetjen e instrumentit TAIEKS të Bashkimi Evropian.

Botimi i Strategjisë u financua nga projekti i BE-së „Drejtesia efektive për mbrojtjen e lirive themelore dhe të drejtën e privatësisë në hapësirën online”. Përmbajtja e Strategjisë është përgjegjësi vetëm e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

1. PARATHËNIE.....	7
2. MISIONI DHE VIZIONI I STRATEGJISË PËR ZBATIMIN E SË DREJTËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2025-2030).....	10
3. QËLLIMET STRATEGJIKE.....	11
3.1. Qëllimi strategjik 1 – Autonomi dhe pavarësi e plotë e AMDhP-së.....	11
3.2. Qëllimi strategjik 2 - Harmonizimi i legjisllacionit.....	13
3.3. Qëllimi strategjik 3 - Rritje e vazhdueshme e kulturës për mbrojtjen e të dhënave personale.....	14
3.4. Qëllimi strategjik 4 – Zbatimi i mjeteve për llogaridhënie.....	17
4. HARTA STRATEGJIKE PËR PERIUdhËN 2025-2030.....	19
5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRESIT TË STRATEGJISË.....	20
5.1. Metoda e propozuar për monitorimin e zbatimit të strategjisë.....	20
5.2. Sistemi i propozuar i KPI-së.....	21

LISTA E SHKURTESAVE

AMDHP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
OMDHP	Oficer përmbrojtjen e të dhënave personale
RRPMDH	Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave
LMDHP	Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale
TKP	Treguesi kryesor i performancës
IA	Inteligjenca artificiale
BE	Bashkimi Evropian

1. PARATHËNIE

Ky dokument është dokumenti i tretë strategjik për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është hartuar për të shprehur nevojat dhe perceptimet e palëve të interesuara, legjislacionin sipas të cilit ai rregullon, gjendjen aktuale të mbrojtjes së të dhënave personale në vendin tonë dhe sfidat e ardhshme në këtë fushë, të gjitha në kuadër të një qasje të plotë dhe moderne për mbrojtjen e privatësisë dhe e të dhënave personale gjatë periudhës 2025-2030. Në botë, ku vlera dhe volumi i të dhënave po rritet në mënyrë eksponenciale, mbrojtja e të dhënave personale dhe e privatësisë është një temë e rëndësishme dhe burim potencial i avantazhit konkurrues. AMDhP-ja duhet të veprojë në kuadrin e digjitalizimit të vazhdueshëm, duke identifikuar trendët në përpunimin e të dhënave personale dhe rreziqet që sjell për mbrojtjen e të dhënave personale.

Strategjia për zbatimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale për periudhën 2025-2030 është hartuar me ndihmën e ekspertëve nga Komisioni Evropian, përmes së cilës janë organizuar edhe konsultime me përfaqësues nga sektori publik dhe privat dhe shoqatat e qytetarëve. Bashkëpunimi pati një përfitim të madh për AMDhP-në sepse mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale përshton të gjitha fushat e jetës private dhe publike dhe nuk ndalet në kufijtë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për këtë qëllim u mbajt punëtori ku u mblodhën informacione shtesë nga palët e prekura me përfaqësues të komunave, bankave, operatorëve të telekomunikacionit, shoqërive të avokatëve, institucioneve shtetërore, shoqëritë tregtare etj. në të cilën janë shqyrtuar çështjet lidhur me trendët globale dhe sfidat lokale që ndikojnë në mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Informacionet nga këto takime dhe punëtori u përdorën në zhvillimin e qëllimeve të reja strategjike, misionit, vizionit dhe vlerave të AMDhP-së.

Duhet theksuar se ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të dhënave personale është rritur tek kontrolluesit dhe qytetarët përmes LMDhP-së, i cili prezantoi mekanizma të gjerë dhe parandalues për zbatimin që transpozojnë standardet e RRPMDh-së. Për këtë qëllim, kontributi i palëve të interesuara ishte i paçmueshëm në formësimin e Strategjisë, detyra e së cilës është të pasqyrojë ndikimin e zbatimit të ligjit në jetën e qytetarëve dhe kontrolluesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të promovojë rezultate më të mira në nivelin privat dhe profesional, pa bërë kompromis për asnjërën palë.

Gjithashtu duhet pasur parasysh se Strategjia është dokument dinamik dhe nëse është e nevojshme mund të modifikohet ose përshtatet në situata të reja që mund të lindin nga përparimet e përditshme në teknologji, ndryshimet në legjislacion ose aktivitete të tjera që mund të ndikojnë në qëllimet e parapara, supozimet, burimet dhe palët e interesuara.

Në procesin e hartimit, kemi marrë parasysh për bazë strategjitë e mëparshme për mbrojtjen e të dhënave personale, Raportin për Maqedoninë e Veriut për vitin 2024 të Komisionit Evropian dhe udhëzimet në Udhëzuesin për strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes, zbatimit,

monitorimit, njoftimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe multisektoriale.¹ Në këtë kontekst, është përgatitur analizë e përparësive, dobësive, mundësive, kërcënimeve (SWOT), e cila përmbledh vlerësimet e gjendjes aktuale për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Kuadri ligjor solid: AMDhP-ja operon brenda kuadrit ligjor gjithëpërfshirës që është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE-së. • Bashkëpunim dhe rrjetëzim efektiv: Bashkëpunimi ndërmjet OMDhP-së është një avantazh i rëndësishëm. Rrjetëzimi që është specifik për sektorët, si p.sh. në rastin e Odës së Avokatëve dhe komunave, përmirëson më tej efikasitetin e tyre. • Ueb-faqja e AMDhP-së e cila është e thjeshtë dhe e lehtë për t'u përdorur: Ueb-faqja e AMDhP ofron burime dhe informacione të vlefshme dhe në mënyrë lehtë të arritshme. • Të punësuar me përvojë të AMDhP-së - ekip profesionistësh me përvojë dhe ekspertizë në mbrojtjen e të dhënave personale dhe çështjet e privatësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Izolimi i OMDhP-së: OMDhP-të shpesh vepron në izoluar brenda kontrolluesve. Roli i tyre shpesh keqkuptohet, ata nuk kanë ndikim të mjaftueshëm në çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe pavarësia e tyre nuk është mjaftueshëm e garantuar. • Zbatim jo i plotë: Disa dispozita të LMDHP janë të vështirë për zbatim në praktikë. Shumë kontrollues nuk zbatojnë masa të mjaftueshme për të mbrojtur të dhënat personale. • Mospërputhja e legjislacionit sektorial në lidhje me kundërvajtjet me RRPMDh: Sanksionet kundërvajtëse duhet të jenë frenuese, efektive dhe proporcionale, prandaj është e nevojshme të bëhen ndryshimet e duhura në legjislacionin sektorial në lidhje me kundërvajtjet. • Direktiva për zbatimin e ligjit nuk është transponuar: Mungesa e legjislacionit nacional që do të transpononte direktivën e BE-së, në fushën e përpunimit të të dhënave personale nga organet për zbatimin e ligjit, paraqet pengesë të madhe që duhet zgjidhur sa më shpejt të jetë e mundur. • Ndërgjegjësimi i ulët i publikut: Shumë qytetarë nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, për të drejtat e tyre në këtë fushë dhe për mënyrat se si mund të ushtrohen këto të drejta. Situata është pak më e mirë me organet shtetërore, por ka ende shumë vend për përmirësim. • Burime të kufizuara: kufizimet buxhetore dhe numri i reduktuar i të punësuarve mund të pengojnë seriozisht aftësinë e AMDhP-së për të menaxhuar volumnin e shtuar të punës dhe për të kryer me efikasitet detyrat dhe autorizimet.

¹ „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.122/2022

MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ul style="list-style-type: none"> • Njohuri dhe aftësi të fituara: OMDhP-ja duhet të kenë njohuri dhe aftësi për të qenë në gjendje të mbrojnë me vetëbesim rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. • Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave: Lehtësimi i komunikimit ndërmjet OMDhP-së dhe shkëmbimi i përvojave përmes platformës së ndërveprimit mund të jetë i dobishëm për të gjitha palët e interesuara. Takimet e rregullta për tema specifike mund të rrisin besimin dhe të inkurajojnë raportimin e cenimeve të sigurisë së të dhënave personale. • Zgjerimi i trajnimeve për OMDhP-në: Rritja e mundësive të trajnimeve të OMDhP-së do të nxisë kulturë më të fortë të mbrojtjes së të dhënave personale. • Forcimi i rolit të OMDhP-së: Është thelbësore të forcohet pozita dhe pavarësia e OMDhP-së, duke përfshirë përgjegjësitë e tyre të drejtpërdrejta ndaj menaxhmentit më të lartë. • Fushata për ngritjen e ndërgjegjësimit publik: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe të punësuarve në sektorin publik do të rrisë nivelin e njohurive të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe do të krijojë presion mbi kontrolluesit për zbatim më efikas të praktikave për mbrojtjen e të dhënave personale. • Ndërgjegjësimi i menaxhmentit: Është thelbësore të sigurohet që menaxhmenti më i lartë i kontrolluesve të kuptojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. • Konsultime me institucionet: Kërkimi i kontributit nga institucionet për çështjet që janë sfiduese mund të çojë në zbatim më të mirë. • Pavarësia financiare dhe burimet njerëzore: Financimi dhe burimet njerëzore janë jetike për kryerjen efikase të detyrave dhe autorizimeve të Agjencisë. • Optimizimi i ueb-faqes: Komunikimi mund të përmirësohet duke përmirësuar përvojën e përdoruesit të ueb-faqes, duke përfshirë formularët e standardizuar. • Bashkëpunimi ndërkufitar: Përforcimi i lidhjeve me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe organizatat ndërkombëtare mund të përmirësojë përpjekjet për zbatimin e ligjit dhe të mundësojë harmonizimin me praktikatat ndërkombëtare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e harmonizimit: AMDhP-jandoshta do t'i duhet të funksionojë në një kuadër ligjor ku ligjet nuk janë të harmonizuara me njëri-tjetrin ose nuk janë të harmonizuara me legjislacionin e BE-së. • Mungesa e pavarësisë: AMDhP-së ndoshta do t'i duhet të vazhdojë të dorëzojë planet e saj të punësimit në Ministrinë e Financave dhe institucioneve tjera. • Kufizimet në lidhje me zbatimin e ligjit: Kompetencat e AMDhP-së për të zbatuar sanksione kundërvajtëse kundër shkelësve të dispozitave të këtij ligji mund të jenë jo frenuese, jo efektive dhe jo proporcionale. • Mos miratimi i ndryshimeve në LMDHP për të lehtësuar transferimin e të dhënave personale, i cili është i një rëndësie thelbësore për të shmangur komplikimet dhe për të mundësuar konkurrencën e kontrolluesve dhe përpunuesve vendas në tregjet e BE-së dhe vendeve të treta. • Sfidat që dalin nga Rregullorja për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale: Disa rregulla sigurie të përcaktuara nga AMDhP-ja mund të jenë jopraktike për t'u zbatuar (p.sh. kontrollet mujore në të dhënat e qasjes së autorizuar). • Distanca e qytetarëve me OMDhP-në: Mungesa e burimeve adekuate për të mbajtur komunikim të rregullt mund të rezultojë me ulje të besimit.

2. MISIONI DHE VIZIONI I STRATEGJISË PËR ZBATIMIN E SË DREJTËS PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (2025-2030)

Duke marrë parasysh të lartpërmendurën, jemi pajtuar si në vijim:

- **Misioni**

Misioni ynë është të mbrojmë të drejtat e qytetarëve, duke promovuar kulturën e transparencës dhe përgjegjësisë.

Strategjia përfshin vizionin që i përcakton prioritetet strategjike:

- **Vizioni**

Vizioni ynë është të nxisim mjedis të hapur dhe të harmonizuar për mbrojtjen e të dhënave personale, të forcojmë besimin e publikut në praktikën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe t'i angazhojmë në mënyrë proaktive palët e interesuara.

3. QËLLIMET STRATEGJIKE

Për të përmbushur misionin dhe vizionin, ne kemi veçuar katër qëllime më të rëndësishme strategjike për zbatimin e tyre. Këto qëllime i identifikojnë fushat prioritare të veprimit ku ballafaqohemi me sfidat kryesore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale:

- **Qëllimi strategjik 1:** Autonomi dhe pavarësi e plotë e AMDhP-së
- **Qëllimi strategjik 2:** Harmonizimi i legjislacionit
- **Qëllimi strategjik 3:** Rritje e vazhdueshme e kulturës për mbrojtjen e të dhënave personale
- **Qëllimi strategjik 4:** Zbatimi i mjeteve për llogaridhënie

Më poshtë është dhënë shpjegim më i detajuar i qëllimeve dhe aktiviteteve, ndërsa në Aneksin do të përcaktohen veprimet e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve, duke përfshirë plan veprimi me indikator për matjen e rezultateve.

3.1. Qëllimi strategjik 1 – Autonomi dhe pavarësi e plotë e AMDhP-së

Rezultati i dëshiruar: Interesi ynë kryesor është të sigurojmë që AMDHP-ja të ketë të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen efikase dhe efektive të detyrave dhe autorizimeve të saj, në mënyrë që të theksohet funksionimi i saj autonom, i pavarur dhe i paanshëm siç parashikohet në RRPMDh.

Miratim të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim sigurimin e autonomisë dhe pavarësisë së AMDhP-së në menaxhimin e financave dhe burimeve njerëzore.

AMDHP ka përgatitur Propozim Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për shkak se në ligjin nuk janë zbatuar plotësisht zgjidhjet që do të mundësojnë që AMDHP-ja të ketë të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen efikase dhe efektive të detyrave dhe autorizimeve të saj. Me këto ndryshime dhe plotësime do të sigurohet autonomi dhe pavarësi e plotë në funksionimin e AMDHP-së nga aspekti që pa ndikim (mendime dhe miratime) nga institucionet e tjera të menaxhohë me burime (njerëzore dhe financiare).

Kufizimet buxhetore dhe reduktimi serioz i të punësuarve mund të pengojnë aftësinë e AMDHP-së për të kryer detyrat dhe autorizimet e saj. Me miratimin e Propozim ligjit ë përgatitur për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, do të sigurohen kushte për sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për kryerjen efikase dhe efektive të detyrave dhe autorizimeve të AMDHP-së duke garantuar pavarësinë dhe autonominë e saj në shpenzimin e këtyre fondeve të ndara.

Forcimi i kapaciteteve të AMDhP-së

AMDhP-ja duhet të punojë në vazhdimësi në organizimin e trajnimeve për të forcuar aftësitë e të punësuarve. Të vetëdijshëm për intensifikimin e nevojave në fushë që kërkon njohuri mjaft specifike, të punësuarit e AMDhP-së duhet të jenë të përgatitur kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe kryer supervizionet në bazë të teknologjive të reja (p.sh. zbatimi i sistemeve të bazuara në IA-inteligjencën artificiale). AMDhP-ja duhet të njihet si institucion që promovon vetë-zhvillimin dhe edukimin e të punësuarve, vend sfidues për avancimin e aftësive të të punësuarve dhe ku ata vlerësohen dhe respektohen lartë.

Njëra ndër elementët e rëndësishme për arritjen e pavarësisë së plotë të AMDhP-së është punësimi i pavarur i të punësuarve të rinj me kualifikimet e nevojshme veçanërisht me ekspertizë dhe njohuri të TI-së, si dhe aktivizim të procesit të avancimit të të punësuarve ekzistues sipas vendeve të planifikuara të punës.

Ndryshim të legjislacionit sektorial në lidhje me kundërvajtjet

Sipas RRRPMDH, sanksionet kundërvajtëse duhet të jenë frenuese, efektive dhe proporcionale, për këtë arsye është e nevojshme të bëhen ndryshimet e duhura në legjislacionin sektorial që i referohet sanksioneve kundërvajtëse për të rritur nivelin e gjobave për personat fizikë (personat përgjegjës dhe zyrtarë), si dhe të korrigojnë normat që kanë të bëjnë me vjetërsimin e ndjekjeve kundërvajtëse.

Për të arritur këtë qëllim, AMDhP-ja do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Inicim dhe promovim të nevojës për miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatimin e plotë të tij.
- Përpjekje për menaxhim të pavarur të fondeve buxhetore të ndara të AMDhP-së.
- Edukim të të punësuarve të AMDhP-së, me qëllim të sigurimit të njohurive dhe aftësive adekuata dhe të përditësuara.
- Përmirësim të parashikueshmërisë teknologjike të AMDhP-së, për të siguruar që AMDhP-ja është e pajisur në mënyrë efikase dhe e gatshme për t'iu përgjigjur zgjidhjeve teknologjike që zhvillohen me shpejtësi.
- Sigurim të punësimeve të reja në AMDhP
- Avancim të vazhdueshëm të të punësuarve ekzistues të AMDhP-së
- Inicimi dhe promovim i nevojës për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të legjislacionit sektorial që ka të bëjë me kundërvajtjet dhe zbatimin e plotë të tyre
- Zbatim frenues, efektiv dhe proporcional i sanksioneve kundërvajtëse për të krijuar sjellje të ndryshuar dhe kulturë të përmirësuar harmonizimin me mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e kontrolluesve dhe përpunuesve.

3.2. Qëllimi strategjik 2 - Harmonizimi i legjislacionit

Rezultati i dëshiruar: Harmonizim me legjislacionin e BE-së dhe arritja e nivelit të duhur të harmonizimit të legjislacionit të sektorëve të ndryshëm me LMDhP-së.

AMDhP-ja miratoi Metodologjinë për harmonizimin e legjislacionit sektorial me LMDP-në, e cila përmban udhëzime që rregullojnë veprimet e ministrive në proceset për harmonizimin e legjislacionit sektorial. Kjo përfshin procesin e rishikimit të ligjeve ekzistuese, si dhe procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë miratimit të ligjeve të reja. Megjithatë, detyrimi i vendosur nga LMDhP-ja për të harmonizuar ligjet e tjera në lidhje me përpunimin e të dhënave personale me dispozitat e LMDhP-së, nuk është përmbushur ende plotësisht. Gjithashtu duhet të punohet edhe më tej në harmonizimin me legjislacionin e BE-së nëpërmjet transponimit të plotë të RRPMDH dhe të Direktivës (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimeve, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të sanksioneve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe për shfuqizimin e Vendimi kornizë 2008/977/PVR i Këshillit (Direktiva për zbatimin e ligjit).

Miratim të ligjit për transponimin e Direktivës për zbatimin e ligjit

Mungesa e legjislacionit nacional që do të transpononte direktivën e BE-së në fushën e përpunimit të të dhënave personale nga autoritetet për zbatimin e ligjit, paraqet çështje serioze që duhet zgjidhet sa më parë. Mbetet që në periudhën në vijim të miratohet ligji që do të transponoj Direktivën për zbatimin e ligjit, me qëllim përmbylljen e harmonizimit normativ me legjislacionin e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Harmonizim të ligjeve me legjislacionin e BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Ligjet dhe dispozitat e tjera që rregullojnë përpunimin e të dhënave personale duhet të jenë në harmonizim me dispozitat e LMDhP-së dhe legjislacionit të BE-së. Në këtë kontekst, AMDhP-ja u jep ministrive udhëzime se si dhe në çfarë mënyre të realizojnë vlerësimin e ndikimit të ligjeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë që të mund të mbulojnë dhe shtjellojnë çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave personale.

Në kuadër të harmonizimit me legjislacionin e BE-së është e nevojshme të kryhet edhe harmonizim të rregullores për transferimin e të dhënave personale në drejtim të thjeshtimit të proceseve për transferimin e të dhënave personale, gjegjësisht të propozohen masa të reja lehtësuese për kontrolluesit dhe përpunuesit me qëllim për të thjeshtuar proceset e transferimit të të dhënave personale drejt vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare.

Harmonizimi i legjislacionit nga aspekti i proceseve të digjitalizimit

Si pjesë e strategjisë më të gjerë digjitale të BE-së, janë miratuar ose janë në proces të miratimit disa akte: Rregullativa për e- privatësi, Akti i IA, Akti i menaxhimit me të dhëna, Akti i të dhënave, Rregullativa për zonën evropiane të të dhënave shëndetësore, Akti për shërbimet digjitale, Akti për tregjet digjitale, Direktiva për siguri të rrjetit dhe informacioneve, si dhe akte të tjera, të cilat duhet të pasqyrohen, transpozohen dhe harmonizohen në legjislacionin nacional, për të zbatuar plotësisht

standardet dhe vlerat e reja që i referohen edhe të dhënave personale. Në këto korniza do të duhet të ndërmerren aktivitete për zbatimin e Konventës kornizë për inteligjencën artificiale dhe të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit të Këshillit të Evropës, dhe pas ratifikimit të saj nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Për të arritur këtë qëllim, AMDhP-ja do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Inicim dhe promovim i nevojës për miratimin e Ligjit për transponimin e Direktivës për zbatimin e ligjit.
- Monitorim të ligjeve të propozuara nga ana e ministrive
- Dhënie të mendimeve për ligjet e dorëzuara
- Publikim të rasteve studimore (case study) që shpjegojnë se si zbatohet LMDHP-ja, si përcaktohet mospërputhshmëria me ligjin dhe si zbatohen masat korrigjuese
- Miratim të metodologjisë për Vlerësimin e ndikimit gjatë transferimit të të dhënave personale.
- Promovim të nevojës për të transponuar aktet që rezultojnë nga strategjia digjitale e BE-së.
- Promovim i nevojës për zbatimin e Konventës kornizë për inteligjencën artificiale dhe të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit të Këshillit të Evropës.

3.3. Qëllimi strategjik 3 – Kritje e vazhdueshme e kulturës për mbrojtjen e të dhënave personale

Rezultati i dëshiruar: Kontrolluesit nga sektori publik dhe privat janë të informuar dhe përgjegjës (llogaridhënës) për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, ndërkohë që qytetarët i kuptojnë më mirë të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, dinë ti ushtrojnë vetë ato të drejta dhe në cilat situata ti referohen AMDhP-së.

AMDhP-ja njihet si promotor dhe mbrojtës të së drejtave dhe lirive themelore gjatë përpunimit të të dhënave personale. Por përveç përpjekjeve të vazhdueshme të AMDhP-së dhe partnerëve të saj për të organizuar dhe zbatuar programe dhe veprime të suksesshme për ndërgjegjësimin e publikut, ekziston ende nevoja e fuqishme për të rritur nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale nga njëra anë dhe nga ana tjetër gjithashtu duhet përmirësuar kultura e përgjithshme gjatë përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesit, përpunuesit dhe shfrytëzuesit. AMDhP-ja gjithashtu nxit vazhdimisht bashkëpunimin ndërkombëtar me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, gjë që kontribuon në përmirësimin e kulturë për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas vlerave dhe standardeve evropiane.

Forcimi i bashkëpunimit me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe organizatat dhe organet e tjera ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar është i rëndësishëm për krijimin e një praktike të unifikuar për çështje të caktuara dhe ndihmon në monitorimin e mendimeve, udhëzuesve dhe praktikave të mira të organeve mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. AMDhP-ja ka statusin e vëzhguesit të punës së Bordit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale, merr pjesë aktive në seancat plenare të Komitetit të Konventës 108/81 të Këshillit të Evropës, realizon bashkëpunim rajonale me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen të të dhënave personale përmes Inicativës 2017 dhe merr pjesë në ngjarje të organizuara nga organizata dhe organe të tjera ndërkombëtare. Trajtimi efektiv i çështjeve ndërkombëtare nga ana e AMDhP-së do të arrihet me aktivitete më të gjera dhe zhvillimin e mekanizmave për bashkëpunim ndërkombëtar, përgatitjen e procedurave për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe përmirësimin e marrëdhënieve me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me organizatat dhe organet e tjera ndërkombëtare.

Bashkëpunim i vazhdueshëm me sektorin publik, privat dhe civil

Bashkëpunimi me sektorin publik, privat dhe civil është thelbësore për të krijuar kornizë të fortë për mbrojtjen e të dhënave personale që plotëson nevojat e shoqërisë, duke siguruar njëkohësisht përgjegjshmëri dhe transparencë në praktikën e përpunimit të të dhënave personale. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale nuk është një e drejtë “e izoluar”, por ka shumë të drejta të tjera të ngjashme që janë plotësuese dhe shpesh është e nevojshme të kryhet balancim.

Prandaj, në kuadër të këtij bashkëpunimi, fokus i veçantë do t'i kushtohet forcimit të bashkëpunimit me kontrolluesit e sektorit publik përmes organizimit të punëtorive, takimeve, takimeve koordinuese dhe trajnimeve për udhëheqësit e lartë, OMDhP-së, si dhe të punësuarit e sektorit publik, me qëllim të rritjes së efektivitetit të promovimit të kompleksitetit të të drejtave të garantuara me kushtetutë duke vendosur legjislacion të harmonizuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndonëse kompetenca bazë e AMDhP-së është mbikëqyrja e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të personave fizikë, megjithatë AMDhP-së ka edhe rol parandalues në drejtim të zhvillimit të ndërgjegjësimit për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Në shumë raste, subjektet e të dhënave personale nuk janë mjaftueshëm të informuar për të drejtat e tyre, përkatësisht për mënyrën e ushtrimit të këtyre të drejtave. Në këtë drejtim, shoqatat e qytetarëve (sektori civil) kanë rol të shtuar në drejtim të informimit dhe edukimit për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe të drejtën e privatësisë. Ata zotërojnë njohuri dhe ekspertizë të specializuar për çështje specifike të mbrojtjes së të dhënave dhe luajnë rol jetik në ngritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të drejtat dhe çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë drejtim, AMDhP-ja do të vazhdojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me shoqatat e qytetarëve, si dhe bashkëpunimin me kontrolluesit e sektorit privat, duke organizuar evente dhe takime të përbashkëta.

Trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale

Njëra ndër detyrat e AMDhP-së, është kryerja e trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim që të gjithë palët (OMDHP, kontrolluesit, përpunuesit, etj.) që përpunojnë të dhënat personale, ta bëjnë këtë në mënyrë transparente, të drejtë dhe ligjore. Duke përmirësuar cilësinë e trajnimeve dhe në përgjithësi duke ngritur nivelin e zbatimit të tyre, AMDhP-ja do të ndihmojë në edukimin e të gjithë palëve të interesuara për masat që mund të marrin për të mbrojtur më mirë të dhënat personale në punën e tyre të përditshme.

Rritje të transparencës dhe dukshmëri më të madhe të AMDhP-së

AMDhP-ja punon vazhdimisht në rritjen e ndërgjegjësimit që do të rrisë nivelin e njohurive të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë që kontrolluesit/përpunuesit të zbatojnë në mënyrë efektive praktikatat e mbrojtjes së të dhënave personale. Të punësuarit e AMDhP-së mbajnë rregullisht mbledhje dhe takime me palët e interesuara dhe komunikojnë çdo ditë me qytetarët që duan të informohen për të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. AMDhP-ja shfaqet në media (shtyp, radio, TV, platforma interneti), realizon aktivitete në shkollat fillore dhe të mesme me leksione mbi rëndësinë e privatësisë dhe sigurisë në internet si dhe organizon evente në të cilat promovon materiale për ndërgjegjësimin e qytetarëve. Aktivitetet promovuese që rrisin transparencën e punës së AMDhP-së dhe e përmirësojnë komunikimin me grupet e interesuara duhet të jenë më të shpeshta, me atë edhe informimi i rregullt i publikut, përdorimi i materialeve të publikuara në ueb faqen e AMDhP-së, puna me grupet e cenuara të qytetarëve etj.

Për të arritur këtë qëllim, AMDhP-ja, do të ndërmarrëveprimet e mëposhtme:

- Bashkëpunim me ekspertë në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale nga autoritete të tjera mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale, organizata dhe organe ndërkombëtare.
- Bashkëpunim me Këshillin Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale për monitorimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale që ndikojnë në zbatimin e harmonizuar të RRPMDh.
- Bashkëpunim dhe komunikim me autoritetet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale në raste kur bëhet fjalë për çështje urgjente.
- Rritje të numrit të trajnimeve për mbrojtjen e të dhënave personale
- Organizim të ngjarjeve dhe takimeve me kontrolluesit dhe përpunuesit për të promovuar kulturë të hapjes, besimit dhe harmonizimit me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Organizim të punëtorive dhe mbajtje të trajnimeve me kontrollues nga sektori publik për vendosjen e legjislacionit në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Publikim të udhëzimeve dhe informatorëve për qytetarët, përfshirë grupet e cenueshme (të rritur, fëmijë) me qëllim përmirësimin e të kuptuarit të LMDhPOsë në mënyrë që të rritet kontrolli mbi të dhënat e tyre personale.
- Përmirësim të përvojës së përdoruesit të ueb faqes së AMDhP-së, duke përfshirë format e standardizuara të publikimit të përmbajtjes së informacionit.

3.4. Qëllimi strategjik 4 – Zbatimi i mjeteve për llogaridhënie

Rezultati i dëshiruar: Kontrolluesit të kenë projektuar sisteme për përpunimin e të dhënave personale sipas parimit të mbrojtjes teknike dhe të integruar të të dhënave personale në mënyrë që të demonstrojnë dhe vërtetojnë se janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen të dhënave personale.

Me zhvillimin e teknologjisë gjithnjë e më shumë, shtohet edhe rritja e shpejtë e sasisë së të dhënave të përpunuara, ndërsa me këtë edhe rreziku për përpunimin e të dhënave personale. AMDhP-ja do të mbështesë kontrolluesit dhe përpunuesit për të siguruar që ata të përmbushin parimet dhe kërkesat bazë të LMDhP-së, në aktivitetet e tyre të përpunimit të të dhënave personale dhe praktikave të biznesit. Duke ofruar gamë të gjerë të teknikave dhe mjeteve për zbatimin efikas të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes së të drejtave individuale, kontrolluesit/përpunuesit inkurajohen të zbatojnë sisteme që është në përputhje me dispozitat e LMDhP-së.

Përmirësim të mjeteve të llogaridhënies për të avancuar harmonizimin e kontrolluesve

Mjetet e llogaridhënies së privatisisë janë thelbësore për kontrolluesit pasi ndihmojnë në sigurimin e harmonizimit me LMDhP-së. Këto mjete, si mbrojtja teknike dhe e integruar e të dhënave personale, vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale, përcaktimi i OMDhP-së, rregullat e detyrueshme të korporatës, etj., u lejojnë kontrolluesve të dëshmojnë se menaxhojnë në mënyrë aktive me rreziqet e përpunimit të të dhënave personale. Kjo inkurajon besimin tek qytetarët, zvogëlon rreziqet dhe promovon kulturë të mbrojtjes së të dhënave personale tek kontrolluesit. Mjetet e llogaridhënies ndihmojnë kontrolluesit të respektojnë dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, por gjithashtu përmirësojnë praktikave të tyre të menaxhimit të të dhënave personale.

Certifikimi dhe kodekset e sjelljes

Njëra ndër mjetet më efektive për të arritur harmonizimin e kontrolluesve dhe përpunuesve me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale është edhe certifikimi i sistemit të tyre të përpunimit të të dhënave personale. Kjo qasje proaktive mund të zvogëlojë një sërë rreziqe për kontrolluesit/përpunuesit dhe gjithashtu të mbështesë përdorimin efektiv të burimeve të AMDhP-së. Në shumë vende, sektorë kyç që mbulojnë një numër të madh kontrolluesve dhe përpunuesve kanë përgatitur kodekse të sjelljes për të vendosur standarde në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatisisë. Ky është një lloj vetë rregullimi, me njëfarë kontrolli (miratim të kodekseve) nga AMDhP-së, duke siguruar përputhshmërinë e kontrolluesve/përpunuesve, si dhe për mbrojtje më të madhe të subjekteve të të dhënave personale.

Rrjetëzimi i OMDhP-së

OMDhP-së ende nuk kanë ndikim të mjaftueshëm në çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe pavarësia e tyre të kontrolluesit nuk është mjaftueshëm e garantuar. Prandaj, është e nevojshme të forcohet pozita dhe roli i tyre në mesin e kontrolluesve përmes trajnimeve të vazhdueshme të tyre, por edhe përmes ndërgjegjësimit të personave udhëheqës më të lartë për rëndësinë e harmonizimit të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale. Për qëllime të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet OMDhP-së, duhet të shfrytëzohen mundësitë e rrjetit të

OMDhP-së. Duke marrë parasysh rëndësinë e ndërveprimit të ndërsjellë veçanërisht rëndësia e shkëmbimit të praktikave dhe këshillave të mira, rrjeti është mjet i dobishëm për informim më të mirë dhe efikas për punën e OMDhP-së. Brenda rrjetit është e dëshirueshme të formohen grupe të veçanta në nivel sektori për dhënien e këshillave dhe shkëmbimin e pikëpamjeve për çështje dhe probleme të përditshme. OMDhP-të duhet të ndjekin trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të përdorin mjete për vetë-përmirësim.

Aktivitete për përmirësimin e pozicionit të OMDhP-së

Është fakt se OMDhP-së shpesh punojnë në izolim brenda kontrolluesve dhe roli i tyre shpesh keqkuptohet. Për të forcuar pavarësinë e tyre në vendin e punës, AMDhP-ja duhet të kryejë supervizione që kontrollojnë edhe pozicionin e tyre dhe efikasitetin e zbatimit të detyrave të përcaktuara me ligj. Supervizionet duhet të konfirmojnë nëse OMDhP-së në kuadër të kontrolluesit është i përfshirë në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë në të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe nëse mbështetja dhe burimet ofrohen nga kontrolluesi gjatë kryerjes së detyrave të punës, si dhe nëse kontrolluesi punon për të ruajtur njohuritë e tij/saj profesionale etj.

Për të arritur këtë qëllim, AMDhP-ja do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Promovim të mjeteve të llogaridhënies dhe miratimi i dokumenteve për zbatimin praktik të tyre nga kontrolluesit
- Miratim të dokumenteve të certifikimit dhe kodekseve të sjelljes
- Mbatje të konsultimeve, takimeve dhe tryezave rumbullake në lidhje me certifikimin dhe kodekset e sjelljes
- Ndjekje në mënyrë aktive të kodekseve të sjelljes dhe certifikatat për të mundësuar praktikën më të mirë të sektorit dhe harmonizimin demonstrues në aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale.
- Zhvillim të trajnimeve për OMDhP-së dhe certifikimi i tyre
- Aktivizim dhe promovim të rrjetit të OMDhP-së.
- Organizim të takimeve dhe tryezave të rumbullakëta nga AMDhP-ja për komunikim më të mirë me OMDhP-në dhe informimin e tyre për dilemat që kanë në harmonizimin e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Promovim i nevojës për përdorimin e platformës e-mësimi nga OMDhP
- Kryerje të supervizioneve për pozicionin e OMDhP-së brenda kontrolluesve dhe mbajtja e statistikave në lidhje me gjetjet e këtyre supervizioneve.

4. HARTA STRATEGJIKE PËR PERIUDHËN 2025-2030

Harta strategjike më poshtë përmbledh të gjitha qëllimet strategjike të cilat i kemi përcaktuar për periudhën e ardhshme.

Ekzistojnë disa aktivitete të përcaktuara për secilin nga qëllimet, duke identifikuar të gjithë hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerren nga statusi ekzistues në gjendjen e dëshiruar në të ardhmen.

Qëllimet strategjike mund të rishikohen vazhdimisht, në përputhje me situatat e reja, me qëllim që të sigurohet fleksibiliteti i strategjisë.

Aktivitetet duhet gjithashtu të rishikohen rregullisht, duke marrë parasysh kornizën kohore të tyre.

HARTA STRATEGJIKE

Zbatimi i së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2025-2030)	Misioni ynë është të mbrojmë të drejtat e qytetarëve, duke promovuar kulturën e transparencës dhe përgjegjësisë.		
	Vizioni ynë është të nxisim mjedis të hapur dhe të harmonizuar për mbrojtjen e të dhënave personale, të forcojmë besimin e publikut në praktikatat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të angazhojmë në mënyrë proaktive palët e interesuara.		
PERSONAT FIZIKË			
RRITJA E VAZHDESHME E KULTURËS SË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE			
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar	Bashkëpunim i vazhdueshëm me sektorin publik, privat dhe civil	Trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale	Rritja e transparencës dhe dukshmërisë së AMDHP-së
KONTROLLUES			
ZBATIMI I MJETEVE TË LLOGARIDHËNIES			
Promovimi i mjeteve të llogaridhënies dhe miratimi i dokumenteve për zbatimin praktik të tyre nga kontrolluesit	Certifikimi dhe Kodekset e Sjelljes	Rrjetëzimi i OMDHP	Aktivitete për përmirësimin e pozicionit të OMDHP

5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRESIT TË STRATEGJISË

Njëra ndër faktorët e suksesit të menaxhimit të strategjisë është matja/monitorimi i rregullt i progresit për zbatimin e qëllimeve dhe detyrave.

Për të monitoruar këtë progres, janë përcaktuar përmbledhje indikatorësh, që lidhen me hierarkinë e qëllimeve dhe aktiviteteve strategjike.

- Indikatorët kryesorë të performancës në nivel të qëllimeve strategjike të përgjithshme dhe specifike.
- Indikatorët e performancës ose operative, kriteret e suksesit në nivel aktiviteti.

Në tabelën e cila përmbledh qëllimet strategjike, përcaktohen edhe detyrat, aktivitetet e indikatorëve të propozuar/faktorë të suksesit. Vlera fillestare dhe përfundimtare e indikatorëve do të përcaktohen pas përcaktimit të përkufizimit dhe burimeve të të dhënave të indikatorëve. Vlera e indikatorëve do të matet çdo vit. Bazuar në rezultatet, vlerat e synuara do të përditësohen nëse është e nevojshme.

Gjithashtu, AMDhP-ja, do të krijojë mekanizma për bashkëpunim me institucionet kyçe në monitorimin e ecurisë së strategjisë, veçanërisht Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Transformimit Digjital, duke pasur parasysh se arritja e qëllimeve strategjike nuk varet nga AMDhP-ja, por edhe nga prioritetet strategjike të këtyre institucioneve.

5.1. Metoda e propozuar për monitorimin e zbatimit të strategjisë

Hartimi i Strategjisë për zbatimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2025-2030) është punë sistematike, e bazuar në përcaktimin e misionit të strategjisë dhe përfundon me krijimin e planit të veprimit me qëllim të realizimit të vizionit. Me zbatimin e elementeve të Planit të veprimit, aktivitetet do të përmbushen dhe përmbledhja e aktiviteteve do të rezultojë në arritjen e qëllimeve strategjike. Me këtë pritet që të realizohet vizioni dhe të përmbushet misioni i strategjisë.

Për të monitoruar në mënyrë efektive zbatimin e strategjisë, AMDhP-ja, duhet të kontrollojë nëse aktivitetet janë zbatuar dhe nëse qëllimet strategjike janë përmbushur apo jo. Për nivelin e veprimit, duhet të përcaktohen TKP të thjeshta dhe lehtësisht të matshme për të matur nivelin aktual të progresit drejt qëllimit.

Në kapitullin tjetër, përshkruajmë sistemin KPI dhe propozojmë metodë për vlerësimin e rezultateve.

5.2. Sistemi i propozuar i TKP-së

Gjatë hartimit të strategjisë, përcaktohet përmbledhje e TKP-së për matjen e nivelit të përmbushjes së qëllimeve dhe aktiviteteve strategjike. Në tabelën e mëposhtme japim përkufizim, përshkrim dhe metodë të matjes së TKP-së, së dhënë.

- Aktivitetet mund të konsiderohen «të përmbushura» nëse TKP-ja përkatëse plotëson vlerën e synuar, tregon zhvillimin e kërkuar përmes %, numrit ose indikatorit Po/Jo.
- qëllimet strategjike mund të konsiderohen të “përmbushura” nëse përmbushen të gjitha detyrat që u përkasin.

Praktikisht kemi dy kategori të TKP-së:

- TKP sasiore: Të cilat tregojnë numrin absolut ose përqindjen e përmbushjes së numrit total, i cili është i rëndësishëm nga pikëpamja e aktivitetit të dhënë. Është shumë e rëndësishme që ky TKP të bazohet në një llogaritje objektive të të dhënave faktike. Prandaj, këto TKP janë të lidhura me bazat e të dhënave/regjistrave që janë tashmë të disponueshme në AMDhP.
- TKP të bazuara në ngjarje/raste (të llojit Po/Jo): të cilat tregojnë suksesin e një sërë veprimesh që synojnë një çështje të vetme (si psh. vendimi për miratimin e Direktivës për zbatimin e ligjit).

TKP - TË E PROPOZUARA

Në tabelën e mëposhtme, japim informacionet më të rëndësishëm në lidhje me TKP-në, të përcaktuara në Planin e veprimit për secilin prej aktiviteteve:

QËLLIMI STRATEGJIK 1: Autonomi dhe pavarësi e plotë e AMDhP-së

Aktiviteti 1: Miratim të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me qëllim sigurimin e autonomisë dhe pavarësisë së AMDhP-së në menaxhimin e financave dhe burimeve njerëzore.

TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Miratim të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	Tremujori i fundit i vitit 2025 - tremujori i parë i vitit 2026	Po/Jo
% e fondeve të përdorura për punësim	2025 - në vazhdimësi	%
% e fondeve të përdorura për avancimin e të punësuarve	2025 - në vazhdimësi	%
% e fondeve të përdorura për profesionalizimin e të punësuarve	2025 - në vazhdimësi	%
% e fondeve të përdorura për shpërbllim të të punësuarve	2025 - në vazhdimësi	%

Aktiviteti 2: Forcim të kapaciteteve të AMDhP-së

TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i të punësuarve të rinj	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i avancimeve të të punësuarve	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i trajnimeve për të punësuar	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i pajisjeve të reja të furnizuara harduerike dhe softuerike	2025 - në vazhdimësi	Numri
% e programeve (sistemeve) aplikative të transferuara në cloud	2025 - në vazhdimësi	%

Aktiviteti 3: Ndryshim të legjisllacionit sektorial në lidhje me kundërvajtjet

TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Miratohe ndryshime dhe plotësime në legjisllacionin sektorial për kundërvajtjet	Tremujori i fundit i vitit 2025 - tremujori i parë i vitit 2026	Po/Jo
Numri i kërkesave të dorëzuara për iniciimin e procesit kundërvajtës	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i sanksioneve të shqiptuara kundërvajtëse	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i sanksioneve të realizuara kundërvajtëse	2025 - në vazhdimësi	Numri

QËLLIMI STRATEGJIK 2: Harmonizimi i legjislacionit

Aktiviteti 1: Miratim të Ligjit për transponimin e Direktivës për zbatimin e ligjit		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Miratim të Ligjit për transponimin e Direktivës për zbatimin e ligjit	Tremujori i fundit i vitit 2025 - tremujori i parë i vitit 2026	Po/Jo
Aktiviteti 2: Harmonizim i plotë i ligjeve me legjislacionin e BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
% e programit vjetor të Qeverisë për ligjet e harmonizuara me LMDHP	2025 – në vazhdimësi	%
% e programit vjetor të Qeverisë për ligjet e harmonizuara me Direktivën për zbatimin e ligjit	2025 - në vazhdimësi	%
Numri i mendimeve të kërkuara për dispozita	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i dispozitave që kanë kryer vlerësim sipas Metodologjisë për harmonizimin e legjislacionit sektorial	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i vlerësimeve të ndikimit të dorëzuara gjatë transferimit të të dhënave personale	2025 - në vazhdimësi	Numri
Miratimi i metodologjisë për ndikimin gjatë transferimit të të dhënave personale	Tremujori i dytë i vitit 2026	Po/Jo
Aktiviteti 3: Harmonizim i legjislacionit nga aspekti i procesit të digjitalizimit		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i ligjeve të miratuara për transpozimin e paketës digjitale	2025 - në vazhdimësi	Numri
Numri i konsultimeve të mbajtura për paketën digjitale	2025 - në vazhdimësi	Numri
Udhëzime të miratuara, sugjerime, dokumente të brendshme që shtjellojnë çështje nga paketa digjitale	2025 - në vazhdimësi	Numri

QËLLIMI STRATEGJIK 3: Rritja e vazhdueshme e kulturës për mbrojtjen e të dhënave personale

Aktiviteti 1: Forcimi i bashkëpunimit me organet mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave personale dhe organizatat ndërkombëtare dhe organet e tjera		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i aktiviteteve	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e AMDhP-së	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Aktiviteti 2: Bashkëpunim i vazhdueshëm me partnerë nga sektori publik, privat dhe civil		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i ngjarjeve të organizuara me palët e interesuara	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i pjesëmarrësve në ngjarje	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i memorandumëve të lidhura	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Publikimi i materialeve (broshura, informator)	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
% e kërkesave të dorëzuara nga ana e qytetarëve në formë elektronike	Në mënyrë të vazhdueshme	%
Aktiviteti 3: Trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i trajnimeve për kontrolluesit	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i trajnimeve për të punësuarit	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i pjesëmarrësve të regjistruar për trajnim në e- mësimi	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i personave që kanë kaluar me sukses trajnimin në e-mësimin	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Aktiviteti 4: Rritja e transparencës dhe dukshmërisë së AMDhP-së		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i takimeve me palët e interesuara	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i personave fizik pjesëmarrës në takime	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i paraqitjeve publike në media (shtyp, TV, internet, radio)	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i aktiviteteve promovuese (anketime, realizimi i fushatave)	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i vizitorëve të ueb faqes	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i materialeve të publikuara në ueb faqe	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i pjesëmarrjes së të punësuarve të AMDhP-së në ngjarje publike	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Numri i pjesëmarrësve nga AMDhP-ja në ngjarje publike	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Press - klipet	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri

QËLLIMI STRATEGJIK 4: Zbatimi i mjeteve për llogaridhënie

Aktiviteti 1: Përmirësimi i mjeteve të llogaridhënies për të promovuar harmonizimin e kontrolluesve dhe përpunuesve		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i dokumenteve të miratuara për të promovuar mjetet e llogaridhënies	2026- në vazhdimësi	Numri
Aktiviteti 2: Certifikimi dhe kodekset e sjelljes		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Numri i konsultimeve, tryezave të rrumbullakëta, takimeve dypalëshe lidhur me certifikimin dhe kodekset e sjelljes	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Dokumentet e miratuara të certifikimit dhe kodekset e sjelljes	2027 - në vazhdimësi	Numri
Numri i trajnimeve për OMDhP-së gjatë proceseve të certifikimit	2028 - në vazhdimësi	Numri
Aktiviteti 3: Rrjetëzimi i OMDHP		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
Rrjeti i themeluar i OMDhP-së	2026	Po/Jo
Numri i aktiviteteve të kryera në rrjet	2026 - në vazhdimësi	Numri
Numri i kontrolluesve që kanë njoftuar se kanë caktuar OMDhP-së	Në mënyrë të vazhdueshme	Numri
Aktiviteti 4: Aktivitete për përmirësimin e pozicionit të OMDhP-së		
TKP	Afati kohor	Rezultati/statusi
% e supervizioneve kontrolluese nga numri i përgjithshëm i supervizioneve të kryera (të rregullta dhe të jashtëzakonshme)	Në mënyrë të vazhdueshme	%
% e rezultateve të anketave të realizuara mbi rolin, përgjegjësitë dhe detyrat e OMDhP-së	2025 - në vazhdimësi	%

